

VENDIM
Nr. 659, datë 27.8.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE E TË KRITEREVE TË SIGURISË, PJESA E SHTATË, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-së, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT DHE TË LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e shtatë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pjesën e shtatë të rregullave teknike për industrinë e gazit të përfshihen rregulla për sistemin e transmetimit e të shpërndarjes, referuar kodeve të praktikave në vazhdim, si më poshtë vijon:

a) rregullat teknike për industrinë e gazit, udhëzuesi teknik G 403, mars 2013, “Mbështetja e vendimit për mirëmbajtjen e rrjeteve të shpërndarjes së gazit”;

b) rregullat teknike për industrinë e gazit, Kodi i Praktikave G 412, tetor 2010 “Mbrojtja katodike nga korrozioni (MKK) i rrjeteve dhe linjave të shpërndarjes së gazit nën tokë”;

c) rregullat teknike për industrinë e gazit, Kodi i Praktikave G 414, dhjetor 2008 “Linjat e gazit mbi tokë”;

ç) rregullat teknike për industrinë e gazit, Kodi i Praktikave G 459-1, qershor 2019 “Linjat e shërbimit të gazit për presione operimi deri në dhe përfshi 5 bar”;

d) rregullat teknike për industrinë e gazit, Kodi i Praktikave G 1020, janar 2010 “Sigurimi i cilësisë për planifikimin, ndërtimin, modifikimin, mirëmbajtjen dhe operimin e instalimeve të gazit”;

dh) rregullat teknike për industrinë e gazit, rregullorja e lidhjes në rrjet me presion të ulët, nëntor 2006 “Rregullore në lidhje me kushtet e përgjithshme për lidhjen në rrjet dhe përdorimin e tij për furnizimin me gaz me presion të ulët (RRLPU)”;

e) rregullat teknike për industrinë e gazit, Kodi i Praktikave GË 315, dhjetor 2019 “Masat për mbrojtjen e impianteve të furnizimit gjatë punimeve ndërtuese”;

ë) udhëzuesi teknik për industrinë e gazit, Kodi i Praktikave G 686, korrik 2013 “Përcaktimi i sasisë në pikat e ndërldhjes së rrjetit ndërmjet operatorëve të rrjetit”.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe